

VENDIM
Nr. 51, datë 31.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 786, DATË 9.11.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE RASTET E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE SI DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 9, e 60, pika 1, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 786, datë 9.11.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në kreun IV, "Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të bordit", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Kryetari dhe anëtarët e bordit shpërblehen çdo muaj, në një masë, të paktën, të barabartë, por jo më shumë se 10 për qind më të lartë se masa e shpërblimit të anëtarëve të këshillit drejtues të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të bordit. Pagesa, për këtë qëllim, sigurohet nga të ardhurat e tjera të bordit (jo nëpërmjet buxhetit të shtetit), në përputhje me rregulloren mbi të ardhurat, të miratuar prej tij."

ii) Pas pikës 12 shtohen pikat 12.1 e 12.2, me këtë përmbajtje:

"12.1. Në rastet kur bordi kërkon financim nga buxheti i shtetit, atëherë shpërblimi i anëtarëve të tij do të jetë në masën e përcaktuar në aktin ligjor në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore.

12.2. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë raporton pranë bordit, brenda muajit janar të çdo viti, shumat e honorareve për këshillin drejtues, të cilat do të shërbejnë si referencë për përcaktimin e shpërblimeve të anëtarëve të bordit."

iii) Pas pikës 13 shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

"14. Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është organi që përfaqëson bordin."

b) Pas kreut IV shtohet kreu IV/1, me këtë përmbajtje:

"IV/1. Mënyra e funksionimit dhe niveli i pagave të strukturës mbështetëse

1. Bordi, në ushtrimin e funksioneve të veta mbikëqyrëse, të sigurimit të cilësisë dhe administrative, asistohet nga një strukturë mbështetëse. Struktura mbështetëse përbëhet nga personeli i përhershëm dhe nga komisionet e grupet e punës të ngritura nga bordi. Personeli i përhershëm i strukturës mbështetëse do të përbëhet nga jo më pak se 10 punonjës, përkatësisht, 1 drejtor ekzekutiv, minimalisht 5 inspektorë të lartë, që do të angazhohen në kontrollin e sigurimit të cilësisë, si dhe, të paktën, 4 punonjës administrativë mbështetës.

2. Bordi, në përputhje me pikën 8, të nenit 4, të ligjit, për përmbushjen e funksioneve të veta miraton organikën e strukturës mbështetëse, në përputhje me praktikat më të mira të institucioneve homologe, si dhe me të ardhurat e siguruara.

3. Në përputhje me pikën 6, të nenit 4, të ligjit, bordi mund të angazhojë ekspertë të jashtëm për të kryer kontrollin cilësie specifike apo për çështje të tjera, të lidhura me kontrollin e cilësisë.

4. Kriteret e përzgjedhjes së ekspertëve të jashtëm përcaktohen në rregulloren e miratuar nga bordi, në përputhje me shkronjat "a" dhe "c", të pikës 5, të nenit 4, të ligjit.

5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të strukturës mbështetëse rregullohen në përputhje me Kodin e Punës, sipas pikës 8, të nenit 4, të ligjit. Procedura e detajuar e emërimit të punonjësve dhe detyrat që duhet të përmbushë stafi i strukturës mbështetëse përcaktohen në rregulloren e hartuar nga bordi.

6. Niveli bazë i pagave të stafit të strukturës mbështetëse do të ketë si referencë strukturën e pagave për nëpunësit civilë, të barasvlershme me funksionet, si më poshtë vijon:

a) Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i barasvlershëm me funksionin “Drejtor i Përgjithshëm në ministri”, në kategorinë II-a;

b) Inspektor i lartë për kontrollin e sigurimit të cilësisë, i barasvlershëm me funksionin “Drejtor drejtorie në ministri”, në kategorinë II-b;

c) Specialist në administratën e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i barasvlershëm me funksionin “Specialist në ministri”;

ç) Punonjësit mbështetës kanë strukturën e pagës së punonjësve mbështetës në administratën publike.

7. Bordi përcakton në rregullore kriteret e shpërblimit nga të ardhurat e veta për strukturën mbështetëse, por jo më shumë se dy paga në vit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama